



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 43 Datë 13.06 2023

“Për zgjedhjen e komisionit të votimit për Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin e Këshillit Bashkiak”

Mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 48, **Mbledhja e parë e këshillit bashkiak**, pika 5, *Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë*; neni 54, **Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak**, gërma a) *zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet*, neni 55, pika 3, *Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji*; Rregullore për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës, neni 15, pika 6; Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e tij të parë;

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e komisionit të votimit, mbështetur në nenin 55, pika 3 me shumicë të votave, të Z. Ermir Tahiri- Kryetar, Z. Samed Hasmegaj- Sekretar, Zj. Franga Kola-Anëtar.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Ardian ÇELEPIJA



Këshilltari më i vjetër në moshë
Frano Prenga

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 16.06.23